REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 8916 prot

Roskovec,më 03.10.2022

VENDIM

NR 70 .DATË 30 .09 .2022

"PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT PËR FILLIM PUNIMESH TË MIRËMBAJTJES SË ZAKONSHME"

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"*, i ndryshuar, neni 22 pika 1 dhe pika 4 dhe neni 54 gërma n, ligjit nr.107 31.07.2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*dheVKM-në nr. 408 datë 13.05.2015 *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"* i azhornuar neni 6,Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

1- Miratimin e Formularit të Vetëdeklarimit për fillim punimesh që nuk kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi.
2- Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimit.
3- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR
Kadri Hyska

REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA ROSKOVEC

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Nr.8704/1 prot Roskovec , më 23.09.2022

Lënda: Relacion shpjegues për projektvendimin "Për miratimin e ndryshimeve në formularin e vetëdeklarimit për fillim punimesh të mirëmbajtjes së zakonshme"

KËSHILLIT TË BASHKISË

Roskovec

Projektvendimi "Për miratimin e ndryshimeve në formularin e vetëdeklarimit për fillim punimesh të mirëmbajtjes së zakonshme" është propozim i mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"*, i ndryshuar, neni 22 pika 1 dhe pika 4 dhe neni 54 gërma n, ligjit nr.107 31.07.2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"* dhe VKM-në nr. 408 datë 13.05.2015 *"Për mirarimin e rregullores së zhvillimit të territorit"* i azhornuar neni 6.

Nga azhornimi I fundit I ligji 17.12.2015 si edhe nga nevoja që kemi për miratim të një formati të ri të vetëdeklarimit për fillim punimesh është rihartuar formati sipas ndryshimeve të fundit

Bashkëlidhur këtij relacioni do të gjeni:

- Formatin e formularit të vetdeklarimit.

Konceptoi:E.Hatia

Miratoi:E.Hoxha

K R Y E T A R
Majlinda Bufi

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSKRYETARI
Maksim Goga

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC

VETËDEKLARIM PËR FILLIM PUNIMESH TË MIRËMBAJTJES SË ZAKONSHME

(*sipas nenit 6 të Rregullores së Zhvillimit-i ndryshuar*)

Nr._____Prot datë____.____.2022

Përshkrimi i objektit ku do të kryhen punimet:_____

Adresa:_____

Aplikanti:_____Telefon:_____

Specifikim i detajuar i llojit të punimeve:

1. Ndërhyrje të mirëmbajtjes së zakonshme që përfshijnë:

1.1 Ndërhyrje të jashtme për riparimin dhe zëvendësimin e rifiniturave të jashtme të ndërtesave, me kusht që të ruhen karakteristikat origjinale të tyre, si:

☐ Rifreskim i lyerjes, suvatimit dhe veshjes së fasadave me material që kanë karakteristika dhe ngjyra të njëjta me ato ekzistuese; , si dhe vendosja e skelave;

☐ Ndërhyrjet me qëllim ruajtjen apo rritjen e eficiencës energjetike dhe akustike në një strukturë ekzistuese, që nuk prekin sistemin konstruktiv të ndërtesës (p.sh. ndërhyrje në themele, mure mbajtëse, tra-kolonë etj.);

☐ Pastrim i fasadave;

- [ ] Riparimi dhe zëvendësimi i dritareve dhe dyerve, qepenave dhe vitrinave (duke përfshirë përdorimin e materialeve të ndryshme), pa ndryshuar karakteristika të tilla si forma, ngjyra, dizajni dhe dimesionet e pjesëve të hapura dhe transparente;

- [ ] Zëvendësimi, riparimi i pjesshëm i mbulesës së çatisë, pa ndonjë ndryshim të formës pjerrësisë dhe karakteristikave të veshjes;

- [ ] Riparimi dhe zëvendësimi i ulluqeve dhe oxhakëve, edhe me materiale të ndryshme;

- [ ] Riparimi i ballkonëve, tarracave dhe basamakëve apo barrierave mbrojtëse;

- [ ] Vendosja e hekurave mbrojtëse në dritare;

- [ ] Vendosja e tendave të diellit dhe rrjetave kundër mushkonjave;

- [ ] Sistemimi i oborreve;

- [ ] Sistemimi i shtresave të dheut, por jo betonizimi i tyre;

- [ ] Riparimi i rrethimeve ekzistuese;

1.2 Ndërhyrje të brendëshme:

- [ ] Riparimi dhe rinovimi i dyshemeve;

- [ ] Riparimi dhe restaurimi i suvasë, veshjeve dhe ngjyrave;

- [ ] Riparimi dhe rinovimi i dyerve dhe dritareve, përfshirë vendosjen e xhamave

☐ hapja dhe mbyllja e dyerve të brendshme;

☐ krijimi, eliminimi ose ndryshimi i mureve ndarës (jombajtës) të brendshëm;

☐ realizimi i impianteve të reja higjieno-sanitare dhe të ngrohjes/ftohjes

1.3 Ndërhyrje në impiante higjeno-sanitare;

☐ Veprat e riparimit dhe zëvendësimit të pajisjeve higjeno-sanitare dhe riparimet e impiantit;

☐ Veprat e riparimit dhe të zëvendësimit të pajisjeve elektrike dhe riparimet e sistemeve elektrike.

☐ 2.Punimet për eleminimin e barrierave arkitektonike dhe përshtatjen e ndërtesave për personat me aftësi të kufizuara

☐ 3.Lëvizjet e dheut qe lidhen, në mënyrë të posacme, me ushtrimin e veprimtarisë bujqësore ose blegtorale, përfshirë ndërhyrjet në impjante hidraulike bujqësore

Punimet do të vazhdojnë deri në _____ ditë pas dorëzimit të këtij vetëdeklarimi.

Dokumenta shoqëruese të vetëdeklarimit:

- Kartë identiteti
- Vërtetim që ka shlyer detyrimet
- Certifikatë pronësie/ Dokumentacion tjetër që lidhet me pronësinë
- Mandatpagesa
- Fotografi të objektit

Unë jam i vetëdijshëm se një devijim nga vetëdeklarimi i mësipërm lidhur me kryerjen dhe cilësinë e punimeve të përcaktuara prej meje dhe nga kërkesat e ligjeve në fuqi për interesin publik, mund të hapin procedura për kundravajtje kundër meje.

Vetëdeklaruesi

Emër Mbiemër (Nënshkrimi)

_____

Nëpunësi që pranon kërkesën

Emër Mbiemër (Nënshkrimi)

_____

DREJTORI

Emër Mbiemër (Nënshkrimi)

_____

K R Y E T A R

Majlinda Bufi

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZËVENDËSKRYETARI

Maksim Goga